

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA
GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, GUSHT 2018**

1. Është rrethuar numri 1: Që t'i inkurajojë virtytet e saj dhe t'i tregojë për pengesat – **1 pikë**
2. Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** nëse shkruan të paktën tri cilësi: *inteligjente, e butë, trimëreshë, krenare, e sinqertë, gaztore, fisnike, luftarake, e sigurt, e fuqishme, krenare dhe e përzemërt...*
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan ose perifrazon fjalitë: *Por të rriturit ia teprojnë në kuptimin tjetër. Ata janë “praktik”, “konkret”. Do ta vësh: do të thonë që gjithmonë ka pasur të pasur dhe të varfër, se që moti ka pasur mjerim, prandaj edhe uri, privilegje, skllavëri, luftëra.*
4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *I kaplon njëloj frike: nga izolimi dhe kritikën në shoqëri, nga varfëria, mospasuria, obligimet, përgjegjësit, vetmia... (dhe përgjigje tjera të ngjashme)*
5. Është rrethuar numri 3: *Fitimi i përvojës në mënyrë të pavarur* – **1 pikë**
6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Ivo Andriq*
7. Është rrethuar numri 3: *kritika* – **1 pikë**
8. Është rrethuar numri 2: *shpirti i njeriut* – **1 pikë**
9. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Andriqi i ka dhënë një shtysë peizazhit nën ndikimin e Dostojevskit dhe Tomas Mani./ Dostojevskit, T. Mani.*
10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Për arsye se veprat e përmendura më së tepërmi i pëlqejnë Andriqit./ Shënimet nga shtëpia e vdekur e kanë shqetësuar Andriqin, kurse mbi Shpirtrat e të së keqes është dridhur në rini (dhe përgjigje tjera të ngjashme)*
11. Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan homonimet: *Verë –pije alkoolike; verë – stina e vitit*
12. Nxënësi merr **1 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë:
shëtitja –rasa emërore
Barbanës – dhanore
Ulqinit – gjinore
Qëndresën – kallëzore
gardhi – emërore

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

13. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *nuk ishte më te rrethoja*

14. Është rrethuar numri 1: *nuk ia bën syri terr – 1 pikë*

15. Gjithsej **2 pikë**:

Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *metafonia*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse shpjegon ndryshimin fonetik: *kalimi apo alternimi i zanores a në e te emrat prej njëjësit në shumës*

16. Nxënësi merr **2 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë:

Qendra Klinike Spitalore e Malit të Zi - QKSMZ

magjistër – *mr.*

e tjerë – *etj.*

për shembull – *p.sh.*

Nxënësi merr **1 pikë** për dy ose tri përgjigje të sakta.

17. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse nënvizon foljen joveprore në mënyrën habitore: *qenkësh*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *veta e tretë*

18. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Gjergj Fishta*

19. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Tragjedisë*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Nga bibla*

20. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *priftit*

21. Nxënësi merr **2 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë: *Juda Makabe është në qendër të veprës, ndërsa konflikti i saj është ndërtuar mbi raportin e interesave të kundërta ndërmjet makabejve, që luftojnë për liri, fe e atdhe, dhe asirasve, që luftojnë për të pushtuar e shtypur popujt tjerë.*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse jep vetëm pjesën e parë të përgjigjes së kërkuar ose vetëm pjesën e dytë të saj.

22. Është rrethuar numri 2: *motivi i dashurisë dhe miqësisë – 1 pikë*

23. Është rrethuar numri 2: *ulërin – 1 pikë*

24. Nxënësi merr **1 pikë** për dallimin elementar: *Gilgameshi dhe Enkiduji kanë qenë miq ashtu që vdekja e Enkidujit është një humbje e madhe për Gilgameshin./ Për arsye se me vdekjen e Enkidujit e humb një mik i cili i kishte dhënë fuqi, por ndien vetmi nga e cila paraqitet frika nga vdekja. (dhe përgjigje tjera të sakta)*

Për një përgjigje të plotë dhe me stil **2 pikë**.

25. Nxënësi merr **2 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë:

Gjon Zaveri – Nga jeta në jetë – pse

Jozef K. – Procesi

Santiago – Plaku dhe deti

Gori Gjinleka – Hasta la vista

Nxënësi merr **1 pikë** për dy ose tri përgjigje të sakta.

26. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *letërsia antike/antika/letërsia e vjetër*

27. Gjithsej **3 pikë** – nxënësi merr nga 1 pikë nëse shkruan saktë titullin e përmbledhjes, autorin e saj dhe titullin e vjershës

Vargjet e lira (1 pikë)

Migjeni (1 pikë)

Kanga e rinisë (1 pikë)

28. Nxënësi merr **1 pikë** për një përgjigje të thjeshtë: *Në të gjitha ndryshimet, përmbysjen e botës së vjetër dhe krijimin e botës së re, poeti njeh si protagoniste rininë.*

Për një përgjigje të plotë dhe me stil **2 pikë**.

29. A) Është rrethuar numri 1: vetën e parë – **1 pikë**

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *thash me veten*

30. Skema për vlerësimin e esesë: **Iluzionet e të riut Rastinjak (Xha Gorio)**

Kërkesa	Nxënësi thekson:
1.	- temën – ngritjet dhe uljet e disa anëtarëve të shoqërisë franceze të shekullit 19 (<i>dhe përgjigje tjera të sakta</i>). (1 pikë) - drejtimin letrar - realizmin (1 pikë)
	Gjithsej 2 pikë

<p>Kërkesa 2.</p>	<p>Nxënësi cekë dy personazhe dhe i përshkruan ata: - (p.sh. plakun Xha Gorio – të cilin dashuria ndaj të bijave e sjellë në pragun e varfërisë; Votrenin – njeriun nga margjinat e shoqërisë, objektiv dhe i paskrupullt, në konflikt me ligjin; zonja Voker – pronarja e pansionit, e shkathët dhe lakmuese; vikontesa de Bozean – gruaja e rangut të lartë të shoqërisë; e pafat në dashuri dhe personazhi i cili nga perspektiva e femrës do t'i japë këshilla Rastinjakut për suksesin në shkallë shoqërore... <i>(nga 1 pikë për personazh të përshkruar shkurtimisht)</i></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 3 pikë</p>
<p>Kërkesa 3.</p>	<p>Nxënësi përshkruan Ezhen de Rastinjakun: - që është një student i varfër i cili vjen nga provinca në Paris <i>(dhe përgjigje të tjera të ngjashme të sakta) (1 pikë)</i> - ka për qëllim që të ketë sukses me mendjen dhe punën e tij sepse jeton në iluzion që në një shoqëri të tillë franceze qëllimet dhe respektimi mund të fitohen me një përpjekje personale... <i>(dhe përgjigje të tjera të ngjashme të sakta) (1 pikë)</i></p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>
<p>Kërkesa 4.</p>	<p>Nxënësi përshkruan vështrimet e para të Rastinjakut në shoqërinë franceze: Rastinjaku konsideron se njohjet sa më të shumta me njerëz sjellin te një sukses më i shpejtë dhe më i madh, se femrat kanë ndikim të madh në jetën shoqërore të Parisit, mendon për mënyrat me të cilat do të prezantohet dhe me të cilat do të pranohet <i>(dhe përgjigje të tjera të ngjashme të sakta) (1 pikë)</i></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 2 pikë</p>
<p>Kërkesa 5.</p>	<p>Nxënësi tregon për dilemat morale të Rastinjakut: - Mendon si të vij deri në majë dhe është i vetëdijshëm për vetëmohimet e shumta: Votren i shpjegon Rastinjakut të ri dhe të papërvojë se para tij janë dy rrugë – vendimet pa kompromis ose gjallërimi në margjinë. Që të ketë sukses duhet “t'i përlyej duart”... <i>(dhe përgjigje të tjera të ngjashme të sakta) (1 pikë)</i> - zgjedh suksesin, dhe me atë rast, edhe pse është i lidhur emocionalisht me xha Gorion, e përdor që të arrij deri te të bijat e tij të cilat i përkasin nivelit më të lartë shoqëror... <i>(dhe përgjigje të tjera të ngjashme të sakta) (1 pikë)</i> - refuzon që t'i përlyej duart me gjak dhe ajo që nuk dëshiron të heq dorë është morali... <i>(dhe përgjigje të tjera të ngjashme të sakta) (1 pikë)</i></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 4 pikë</p>

Kërkesa 6.	<p>Nxënësi përcaktohet për një nga qëndrimet e ofruara dhe e argumenton atë (1 pikë)</p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i></p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>
-------------------	--

Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p>3 pikë</p>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, për emrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali,</p> <p>2 pikë</p>	<p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p>1 pikë</p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellitimit ndan paragrafët)</p> <p>2 pikë</p>
<p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p>	<p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/ rr, dh/ ll, k/</p>		

<p>2 pikë</p>	<p>q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>		
<p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p>1 pikë</p>	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p>1 pikë</p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i</p>		<p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p>1 pikë</p>

	<p>rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>		
--	---	--	--

Skema për vlerësimin e esesë: **Arti i filmit dikur dhe sot**

Kërkesa 1.	<p>- Nxënësi numëron zhanret e artit të filmit. (1 pikë)</p> <p>- Nxënësi veçon një zhanër të cilin e do më së shumti dhe thjeshtë e argumenton përgjigjen. (1 pikë)</p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i></p> <p>Gjithsej 3 pikë</p>
Kërkesa 2.	<p>- Nxënësi thekson domethënien e artit të filmit në të kaluarën. (1 pikë)</p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i></p> <p>- Nxënësi shpjegon rëndësinë e artit të filmit në kohën e zhvillimit të teknologjisë dhe rrjeteve shoqërore. (1 pikë)</p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i></p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>
Kërkesa 3.	<p>- Nxënësi kumton mendimin e vet për skenat e dhunshme në film. (1 pikë)</p> <p><i>Për një shpjegim më të thjeshtë 1 pikë.</i></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i></p> <p>Gjithsej 3 pikë</p>
Kërkesa 4.	<p>- Nxënësi komenton qëndrimin e regjisorit Stenli Kjubrik. (1 pikë)</p> <p><i>Për një komentim më të thjeshtë 1 pikë.</i></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i></p>

	Gjithsej 3 pikë
Kërkesa 5.	- Nxënësi jep qëndrimin për ndikimin e filmit tek të rinjtë. (1 pikë) <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p>3 pikë</p> <p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me</p>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p>2 pikë</p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i</p>	<p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p>1 pikë</p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p> <p>2 pikë</p>

<p>gabime minimale</p> <p>2 pikë</p>	<p>shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>		
<p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p>1 pikë</p>	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p>1 pikë</p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë</p>		<p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p>1 pikë</p>

	<p>mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>		
--	---	--	--